



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga “MIGJENI” (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP. nr. 847/2024

Data e vendimit: 20.09.2022

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “DEMOS” SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, iniciuar nga MINISTRIA E SHËNDETËSISË, në cilësinë e autoritetit kontraktues, ud. Kryesuesi sekretariatit tëi Organit Shqyrtues të Prokurimit me datën: 20.09.2024, mori këtë:

VENDIM

Hedhet si e palejuar (parakohshme) ankesa e “DEMOS” SH.P.K me nr. të protokollit 2024/0847, e datës 13.09.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, iniciuar nga MINISTRIA E SHËNDETËSISË, nga cilësia e tij/saj si autoriteti kontraktues (AK).

I lejohe, autoritetit kontraktues – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

ARSYETIM

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 13.09.2024 ka pranuar ankesën me nr.0847/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E SHËNDETËSISË ndërsa me datë 26.08.2024 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë të AK. Për të cilën OE ankues “DEMOS” SH.P.K në platformën E-Prokurimi nuk figuron që OE ankues ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-së, para se i njëjti t'i drejtohet OSHP-së me Ankesë.

OSHP sqaron se OE Ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me nenin 108/A të LPP-së pas pranimit të vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, brenda afateve ligjore të parashtrujnë kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 1 i LPP-së përcakton se: “Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlihen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.” Ndërsa neni 109 i LPP-së përcakton se: “Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrujë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji lidhur me nenit 59 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, andaj si e tillë hedhet si e pa lejuar në kuptimin si e parakohshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

AK MINISTRIA E SHËNDETËSISË, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë” me numër të prokurimit 206-24-8799-1-1-1, megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Po ashtu, zyra për financa, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Ud Kryesuesi i Sekretariatit i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË

1x1 OE - "DEMOS" SH.P.K

1x1 Arhivës së OSHP-së;

Agim Sheqiri
Ud. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

